

Fletë Informuese

Ky material informativ është përpiluar duke përdorur informacionin e pasqyruar në Raportin Opinione e të Mbijetuarve të Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual si Fëmijë në Internet në Shqipëri.¹



WeProtect Global Alliance mbledh së bashku ekspertë nga qeveritë, sektori privat dhe shoqëria civile për të zhvilluar politika dhe për të gjetur zgjidhje për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual në internet. Kjo aleancë synon të përmirësojë nivelin e angazhimit politik dhe të promovojë masa praktike për ta bërë botën dixhitale të sigurt dhe pozitive për fëmijët, duke parandaluar abuzimin seksual dhe dëmet afatgjata që shkaktohen prej tij.



ECPAT International është një rrjet global me 122 organizata të shoqërisë civile, nga 104 vende, që punojnë për t'i dhënë fund shfrytëzimit seksual të fëmijëve. Duke qenë se ECPAT ka një përvojë mbi 30 vjeçare me angazhimin dhe menaxhimin e projekteve dhe aleancave shumëpalëshe në nivele kombëtare, rajonale dhe globale, ajo konsiderohet si një organizatë lider dhe eksperte mbi të gjitha çështjet dhe elementët që kanë të bëjnë me shfrytëzimin seksual të fëmijëve.



Child Rights Center Albania (CRCA) / ECPAT Albania punon për të promovuar respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve, për t'i mbrojtur ata nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi, për të çuar më tej njohjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri, si dhe për të rritur pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve në procese në nivel kombëtar dhe lokal, përmes lobimit dhe avokimit, përmirësimit të politikave dhe legjisllacionit; përmirësimit të kapaciteteve, mbledhjes së informacionit e punës kërkimore, dhe vënies në jetë të modeleve më të mira të shërbimeve të kujdesit dhe mbrojtjes së fëmijëve. CRCA promovon zbatimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës dhe të gjitha standardeve të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.



ZËRAT E TË MBIJETUARVE të abuzimit dhe shfrytëzimit seksual si fëmijë në Internet në Shqipëri

Projekti kërkimor Zërat e të Mbijetuarve synon të studiojë me hollësi shfrytëzimin dhe abuzimin seksual të fëmijëve në internet në gjashtë vende, duke përfshirë edhe Shqipërinë.² Paraqitja e opinioneve dhe këndvështrimeve të të rinjve të mbijetuar në kuadër të këtij studimi kishte një rëndësi të dorës së parë.

Në kuadër të këtij projekti u zhvilluan paralelisht dy aktivitete për të marrë informacione sa më të sakta:




Bashkëbisedime një për një me të rinj që kishin përjetuar shfrytëzim dhe abuzim seksual të fëmijëve në internet



Një sondazh me punonjës socialë të shërbimeve mbështetëse të vijës së parë që ofrojnë ndihmë për fëmijët e mbijetuar nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual

1. ECPAT International dhe CRCA/ECPAT Albania. (2021). Mendimet dhe Opinione e të Mbijetuarve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual i Fëmijëve Online në Shqipëri. EeProtect Global Alliance.
2. Në projektin Zërat e të Mbijetuarveu përfshinë gjashtë vende: Shqipëria, Bosnjë Hercegovina, Kolumbia, Meksika, Moldavia dhe Peruja.

Kush mori pjesë në këtë projekt?



Një grup prej 50 punonjësish të vijës së parë të frontit në punën me fëmijë, dhe që kanë patur përvojë me të paktën disa raste të shfrytëzimit ose abuzimit seksual të fëmijëve



34
femra



16
meshkuj

84%

Pjesa më e madhe e të anketuarve (42 prej tyre) kishin një diplomë që lidhej direkt me punën e tyre në ofrimin e mbështetjes për fëmijët

Punonjësit e vijës së parë punojnë në organizata që ofrojnë shërbime mbështetëse në

- Zona urbane (28)
- Zona rurale (3)
- Zona urbane dhe rurale (19)



Përkufizimi i shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve në internet

Shfrytëzimi dhe abuzimi seksual i fëmijëve në internet i referohet atyre rasteve kur përdoret teknologjia digjitale, interneti dhe teknologjia e komunikimit përgjatë periudhës së abuzimit ose shfrytëzimit seksual. Këto incidente mund të ndodhin vetëm gjatë komunikimeve në internet, ose nëpërmjet një përzierjeje të ndërveprimeve online dhe kontakteve personale midis keqbërësve dhe fëmijëve.

Shfrytëzimi dhe abuzimi seksual i fëmijëve në internet përfshin një gamë gjithnjë në rritje të sjelljeve dhe metodave abuzive, duke përfshirë këtu: materiale abuzimi seksual të fëmijëve, manipulimin e fëmijëve në internet për qëllime seksuale (grooming), transmetimin e drejtpërdrejtë të abuzimit seksual të fëmijëve, dhe elemente të tjera të ngjashme si ndër të tjera: shantazhin seksual, shpërndarjen pa leje të përmbajtjes seksuale të krijuar nga viktimat kur ishin ende fëmijë, ekspozimin e padëshiruar ndaj materialeve me përmbajtje seksuale.

3. ECPAT International (2020). [Material Përmbledhës: Zhfrytëzimi Seksual i Fëmijëve në Internet \(Summary Paper: Online Child Sexual Exploitation\)](#). Bangkok: ECPAT International.

Gjetjet dhe rekomandimet kryesore

Ky studim i vendos zërat e të mbijetuarve të shfrytëzimit dhe abuzimit seksual si fëmijë në internet në qendër të përpjekjeve për të gjetur një zgjidhje ndaj këtij problemi. Të dhënat dhe rekomandimet e paraqitura këtu bazohen kryesisht në këndvështrimet e tyre në lidhje me mekanizmat ekzistuese të denoncimit (raportimit) dhe shërbimet mbështetëse, dhe duhet që ato të reflektohen në strategji, politika dhe veprime nga zyrtarë, ofruesit e shërbimeve dhe forcat e ruajtjes së rendit.

Mekanizmat e raportimit

- 1. Duhet të ndërmerren dhe promovohen fushata informimi dhe ndërgjegjësimi brenda dhe jashtë shkollave mbi rreziqet në internet në lidhje me shfrytëzimin dhe abuzimin seksual, mekanizmat e denoncimit dhe raportimit, si dhe shërbimet mbështetëse ekzistuese që mund të ofrojnë ndihmë kur lind nevoja.**

Vajzat që morën pjesë në bashkëbisedimet me ekspertët, treguan se kishin shumë pak njohuri mbi mekanizmat zyrtarë të raportimit, edhe pse Qeveria shqiptare dhe organizatat e shoqërisë civile kanë zhvilluar një sërë aktivitete të ndërgjegjësimi dhe edukimi rreth shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve, dhe disa nga këto aktivitete e fushata u drejttoheshin posaçërisht fëmijëve.⁴ Ato gjithashtu përmendën mungesën e njohurive mbi platformat specifike të raportimit dhe linjat telefonike të ndihmës, duke përfshirë edhe platformat në internet dhe ato të krijuara posaçërisht për fëmijët, siç është linja telefonike kombëtare për fëmijë ALO 116-111.

“Unë në ato momente nuk dija që kishte një Linjë për Fëmijët sic është ALO 116 111, ku mund të telefonojë gjithkush dhe të kërkojë ndihmë duke iu ruajtur konfidencialiteti, apo dhe kjo platforma ISIGURT.al që e kam marrë vesh nga ju pasi më ka ndodhur gjëja.”

(VoS-AL-04)⁵

Kjo mungesë informacioni u vu re edhe nga të dhënat e mbledhura nga punonjësit e vijës së parë, pasi 56 për qind e tyre treguan se ndërgjegjësimi publik për shfrytëzimin dhe abuzimin seksual të fëmijëve në internet ishte i dobët. Ata theksuan se:

“Shqipëria është akoma shumë prapa kur vjen puna tek niveli i ndërgjegjësimi se sa serioz është problemi i abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve online dhe offline.”

- 2. Prani më e dukshme në komunitete nga ana e zyrtarëve publikë dhe punonjësve për mbrojtjen e fëmijës.**

Asnjëra nga vajzat nuk kishte dijeni se ekzistonin punonjës të bashkisë për mbrojtjen e fëmijës, përpara se të binin viktimat të shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve në internet. Nuk kishin marrë informacione as nëpërmjet prezantimit në orë të hapura informative në shkollë, as nëpërmjet aktiviteteve të ndërgjegjësimi mbi mbështetjen që mund të sigurojë komuniteti për të rinjtë.

4. ECPAT International. (2020). [ECPAT Country Overview: Albania](#). Bangkok: ECPAT International.

5. Ju lutemi të keni parasysh se teksti në kutitë jeshile paraqet citate nga vajzat e mbijetuarat që morën pjesë në biseda. Teksti në kuti vjollce i referohet informacioneve të marra nga punonjësit e vijës së parë në sondazh.

“Këto punonjëse duhet të dalin në rrugë, të takojnë fëmijë dhe të rinj, ndoshta të prezantohen dhe të ndajnë fletushka informuese se si ne duhet të mbrohemi nga këta persona të këqij që abuzojnë me fëmijë dhe të rinj. Tani, të flasim siç duhet, puna nuk bëhet “hajde ti ke zyra se aty më gjen!”

(VoS-AL-05)

Edhe punonjësit e vijës së parë që iu përgjigjën sondazhit e konsideruan shumë të rëndësishëm rolin e Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijës. Kur u pyetën për hapat praktike që do të ndërmerren për të ndihmuar fëmijët viktimë të shfrytëzimit dhe abuzimit seksual në internet, njëri prej tyre tha se

“[...] në të gjitha rastet [duhet] të ndihet qartë prania e Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijës gjatë periudhës së vëzhgimit me kujdes të fëmijëve dhe familjeve të tyre gjatë këtyre hapave.”

3. Duhet të miratohen ligje që fokusohen në mënyrë specifike në mbrojtjen e fëmijëve në mjedisin digjital.

Aktualisht, Kodi Penal ka mangësi në lidhje me klasifikimin si krim të shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve në internet.⁶

“Si fillim dua të them se duhet që këta persona që kërcënojnë dhe shantazhojnë dhe më pas abuzojnë seksualisht në jetën e përditshme duhet që të marrin dënimin e merituar, dhe jo të dënohen sa me u thënë se u dënuan! Duhet që të ashpërsohen masat dhe të ndryshohen ligje të cilat dënojnë pak ose aspak këta persona që bëjnë keq.”

(VoS-AL-04)

4. Pas denoncimeve, është e rëndësishme që viktimat të marrin informacion të qartë në lidhje me proceset që do të ndiqen dhe të drejtat e tyre gjatë gjithë kohës. Respektimi i këtyre të drejtave duhet të jetë një nga prioritetet kryesore përgjatë fazës së hetimeve dhe proceseve gjyqësore.

Përveç kësaj, organet e ruajtjes së rendit duhet të garantojnë mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave dhe deklaratave. Në të kaluarën media ka publikuar informacione personale për katër nga shtatë vajzat e reja që zhvilluan biseda me ekspertët, duke përfshirë adresat e tyre, inicialet, emrat e prindërve dhe shkollat, intervista që tregonin fytyrën e prindërve, dhe fotografi të shtëpive të tyre. Si rezultat, ato humbën besimin ndaj institucioneve.

“Nuk e kuptoj se si mundet që policia të ndajë të dhëna që unë kam deklaruar për ta në momentin që kam bërë denoncimin! Pse duhet që policia ta bëjë këtë gjë? Kush ia u jep këtë të drejtë? Të njëjtën gjë kanë bërë dhe me rastin tim!”

(VoS-AL-01)

6. ECPAT International. (2020). ECPAT ([ECPAT Country Overview: Albania](#))([ECPAT Country Overview: Albania](#)) 21. Bangkok: ECPAT International.

5. Është e nevojshme që të sigurohen fonde për të ofruar trajnime për forcat e rendit që të përmirësohet procesi i hetimit dhe ndjekjes penale të krimeve seksuale në internet kundër fëmijëve.

Organet e ruajtjes së rendit duhet gjithashtu që të përmirësojnë punën për kryerjen e hetimeve në Shqipëri në lidhje me abuzimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve dhe të rinjve në internet, në mënyrë që të sigurohemi që autorët e krimeve të dalin para drejtësisë, ndërsa viktimat e këtyre krimeve duhet të jenë në gjendje që të përfitojnë kompensime dhe masa të tjera juridike. Kjo do të inkurajojë të rinjtë tjerë që të denoncojnë abuzimin dhe shfrytëzimin seksual në internet.

“Policia duhet që të marrë seriozisht çdo rast që u raportohet dhe denoncohet në kuadër të ngacmimeve seksuale online, kjo sepse ka raste që nuk çohen deri në fund për mungesë provash. Po më fal, për çfarë është policia dhe prokuroria për t’ia gjetur ne provat?!”

(VoS-AL-06)

Të dhënat e mbledhura nga sondazhi me punonjësit e vijës së parë e vunë theksin mbi këtë pikë – 52 për qind e të anketuarve theksuan se nuk kishin dijeni për ndonjë rast ku viktimat e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual në internet të kishte marrë kompensim financiar për krimet që kishin pësuar.

6. Duhet të identifikohen dhe promovohen metoda dhe mënyra për të përmirësuar sistemin e ndihmës psiko-sociale në shkolla.

Të gjitha vajzat që morën pjesë në biseda ishin nxënëse shkollash gjatë periudhës kur ndodhi abuzimi dhe shfrytëzimi në internet, dhe të gjitha thanë se ishte shumë e vështirë që të diskutonin mbi shqetësimet e tyre në këto ambiente - me psikologët ose me stafin pedagogjik.

Katër nga vajzat thanë se shkollat e tyre nuk ishin vënë në dijeni për situatën e krijuar, por edhe stafi pedagogjik apo shërbimet mbështetëse psikosociale në shkolla nuk ishin treguar të vëmendshme ndaj ndryshimeve në sjelljen e këtyre vajzave gjatë asaj kohe. Tre vajza tjetra thanë se edhe pse ishin në dijeni të asaj që po ndodhte, shkollat e tyre nuk ofruan ndihmën e nevojshme.

Psikologët dhe punonjësit socialë duhet të jenë kujdestarë të mirëqënies së fëmijës, dhe duhet të jenë në gjendje që të identifikojnë fëmijët që po përjetojnë shqetësime, dhe të mundësojnë aksesin e tyre në shërbimet e nevojshme mbështetëse.

“Është shumë e rëndësishme që të ketë psikologë të specializuar dhe organizata që të ofrojnë mbështetje psikologjike në çdo moment për këta fëmijë, kjo me qëllim që gjendja emocionale dhe psikologjike që në ato momente mund të jetë e rënduar të mund të përmirësohet.”

(VoS-AL-09)

Shërbimet Mbështetëse

7. Shërbime falas/të subvencionuara me psikologë të trajnuar dhe me përvojë në mbështetjen e fëmijëve viktimat të shfrytëzimit dhe abuzimit seksual si në internet ashtu dhe në botën reale.

Vajzave që morën pjesë në këtë studim, si dhe disa nga pjesëtarët e familjeve të tyre, iu sigurova mbështetje psikologjike afatgjatë për tre, gjashtë muaj ose një vit, të siguruar falas nga organizatat e shoqërisë civile. Problemi është se ndihma psikologjike falas apo e subvencionuar nga qeveria gjendet me vështirësi në Shqipëri.

Këto shërbime mbështetëse duhet të ofrohen në çdo kohë për të gjithë të rinjtë që kanë rënë viktime të shfrytëzimit dhe abuzimit seksual në internet. Disa të rinj thanë se disa psikologë dhe punonjës socialë që ofronin ndihmë nuk ishin ndalur as nga pengesat e terrenit apo motit, dhe kishin ofruar mbështetje duke përdorur forma digjitale të komunikimit. Ky ishte një element pozitiv dhe inkurajues, dhe duhet të zhvillohet më tej në mënyrë që të sigurohet një komunikim i përshtatshëm, konfidencial dhe etik.

“Siç edhe e theksova më lart, është e nevojshme që dhe në qytete të vogla të ketë shërbime miqësore për fëmijët dhe të rinjtë viktime të abuzimit seksual online dhe offline. P.sh, është shumë e rëndësishme që të ketë psikologë të specializuar dhe organizata që të ofrojnë mbështetje psikologjike në çdo moment për këta fëmijë, kjo me qëllim që gjendja emocionale dhe psikologjike që në ato momente mund të jetë e rënduar të mund të përmirësohet. Vetëm se është shumë e nevojshme ta them këtë: “duhet me patjetër që këto shërbime të jenë të vazhdueshme dhe jo thjesht kur është momenti që bëhet mediatike çështja, dhe më pas të harrojnë se çfarë ka ndodhur”!

(VoS-AL-05)

“Pavarësisht se psikologjia e organizatës ka qenë gjithmonë e gatshme të komunikojë me mua, jo gjithmonë ka qenë e mundur ta takoj për shkak të rrugës së prishur, kohës shumë të ftohtë në dimër. Prandaj së bashku me psikologun kemi rënë dakord që ne të komunikojmë përmes telefonit dhe kështu unë nuk jam ndierë asnjëherë vetëm.”

(VoS-AL-01)

Edhe nga të dhënat e sondazhit vihet re se punonjësit e vijës së parë bien dakord me këto pika. Shumë grupe të ndryshme ofrojnë një sërë shërbimesh, por lloji i shërbimeve ndryshon ndjeshëm dhe aty përfshihen si organizata joqeveritare ashtu edhe institucione qeveritare. Punonjësit socialë të vijës së parë gjithashtu vërejtën se vendi i banimit ndikon ndjeshëm në ofrimin e shërbimeve për të rinjtë.

8. Duhet të sigurohet një gamë e plotë mbështetjeje (psikologjike, sociale, juridike, mjekësore) dhe të jetë e disponueshme për fëmijët viktime të shfrytëzimit seksual në përgjithësi dhe online, pavarësisht nga vendbanimi i tyre.

Të gjitha vajzat thanë gjatë bisedave se shërbimet mbështetëse kishin qenë shumë të dobishme, që nga momenti kur ishin vënë në dijeni për ekzistencën e tyre dhe aksesin në këto shërbime, dhe se ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes për një periudhë të gjatë kohore i kishte ndihmuar që ta merrnin veten. Sidoqoftë, aksesin tek këto shërbimeve ishte një nga problemet kryesore për disa prej tyre, veçanërisht për ato vajza që jetonin në qytete të vogla ose në zona rurale.

Disa prej tyre thanë se, nëse shërbimet që iu ofruan pas denoncimit do të ishin të disponueshme në qytetet e tyre para se, ose kur kishin ndodhur incidentet, ato do të ndiheshin më të sigurta, më të mbështetura dhe do të kishin më shumë vetëbesim për të denoncuar dhe për t'u përballur



më lehtë me situatat e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve në internet.

Këto shërbime mund të vihen në dispozicion përmes ngritjes së qendrave të specializuara ku ofrohen shërbime të ndryshme mbështetëse për fëmijë dhe të rinj që bien viktima të shfrytëzimit dhe abuzimit seksual.

“Duhet që të ketë më shumë qendra komunitare, përfshi këtu dhe qytetet e vogla ku të mërret një shërbim dhe mbështetje multidimensionale me qëllim që ti të mund ta marrësh veten lidhur me atë ç’ka ka ndodhur.”

(VoS-AL-05)

Kjo mund të arrihet përmes zgjerimit të aktivitetit të Barnhaus Albania në zona të tjera. Ky model pune ka gjasa të reduktojë rrezikun e ri-traumatizimit të mundshëm të fëmijëve në disa drejtime, duke përfshirë këtu edhe koordinimin e punës së ekspertëve me fëmijët, në mënyrë që ata të dëshmojnë mbi peripecitë e tyre vetëm atëherë kur është e domosdoshme, në një ambient të sigurtë dhe konfidencial.

Nevoja për të përmirësuar disponueshmërinë e shërbimeve mbështetëse për të gjithë fëmijët, pavarësisht zonës ku jetojnë, u përmend edhe nga punonjësit socialë në sondazh:

“[...] ka një diferencë shumë të madhe ndërmjet shërbimeve që ofrohen në zona urbane dhe rurale. Po kështu ka dhe mungesë besimi dhe ngurrim tek fëmijët për të kërkuar ndihmë, pasi edhe shërbimet konfidenciale nuk funksionojnë siç duhet.”

9. Duhet të sigurohen fonde për të financuar trainimin e forcave të zbatimit të ligjit dhe ofruesve të shërbimeve sociale mbi çështjet që lidhen me shfrytëzimin dhe abuzimin seksual të fëmijëve në internet.

Si vajzat që u përfshinë në bashkëbisedime me ekspertë, ashtu dhe punonjësit socialë të vijës së parë që iu përgjigjën sondazhit folën mbi nevojën për të përmirësuar kapacitetet e ofruesve të shërbimeve. Njëra nga vajzat vuri në dyshim nivelin e aftësive të psikologëve në shkolla, duke e lidhur mungesën e profesionalizmit të tyre me ngurrimin e saj për t’iu besuar dhe për t’iu hapur:

“Psikologu vinte një herë në dy apo tre javë dhe ajo çka na thoshte ishte: ‘Hë a keni ndonjë problem? Po patët më thoni...’ Serioziteti i tij në punë ishte zero, si mund t’i besoja unë atij historinë time?”

(VoS-AL-05)

Një nga punonjësit socialë në sondazh e shpjegoi kështu mungesën e njohurive në lidhje me shfrytëzimin dhe abuzimin seksual të fëmijëve në internet:

“Duke qenë se rastet janë të pakta në numër, edhe eksperiencia është goxha e kufizuar, dhe të duket sikur po përballësh papritur me diçka fare të panjohur.”


Njolla e turpit

10. Duhet që të financohen, organizohen dhe zhvillohen fushata ndërgjegjësimi që të eliminohet stigmatizimi i viktimave të krimeve seksuale, duke i bërë të qartë komunitetit se është gjithmonë faji i të rriturve kur shfrytëzojnë fëmijët, dhe se pretendimet e rreme nga keqbërësit se fëmijët 'morën pjesë me dashje' janë të pabaza.

Disa nga vajzat thanë se shtrirja e dorës për ndihmë nuk është aspak gjë e lehtë, si pasojë e njollës së turpit që lidhet me përdorimin e mekanizmave të raporimit dhe kontaktit me shërbimet mbështetëse. Në fakt, të gjitha vajzat preferuan që bisedat të zhvilloheshin në ambientet e CRCA/ECPAT Shqipëri, sepse nuk donin që të shiheshin në ambientet e institucioneve lokale në qytetet ku jetonin.

Njolla e turpit u përmend si një çështje kryesore edhe nga punonjësit socialë në sondazh. Punonjësve të vijës së parë iu paraqit një listë me 18 faktorë që mund të pengojnë denoncimin e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve në internet, dhe në krye të listës u rendit kultura e heshtjes si pengesa më e zakonshme për denoncimin ("njolla e turpit që shpesh përjetohet nga viktimat" – 56 për qind e tyre, ose 28 persona), si dhe "frika se si do të reagojnë të tjerët pas denoncimit" (50 për qind, 25 persona)

Faktorët që mund të bëhen pengesë për denoncim nga ana e fëmijëve.



Këto opinione dhe këndvështrime nxjerrin në pah ndikimin e turpmit me të cilin përballen të mbijetuarit, dhe se qëndrimet e komunitetit mund të ndikojnë negativisht tek ta dhe t'i pengojë që të kërkojnë ndihmë. Një nga vajzat tha se kërkimi i ndihmës mund të jetë diçka e vështirë si pasojë e njollës së turpmit që lidhet me përdorimin e mekanizmave të denoncimit dhe kontaktit me shërbimet mbështetëse:

“Duke qenë se të gjithë bashkëmoshatarët e mi mendojnë se të shkosh tek psikologja do të thotë që je i çmendur, unë asnjëherë nuk kam marrë guximin më përpara që të flisja me një psikologe. Vetëm pasi ndodhi me mua kjo gjë, unë arrita të kuptoja rëndësinë e vërtetë të psikologes.”

(VoS-AL-08)

Frika nga marginalizimi social, e shoqëruar me turpin dhe problemet e tjera emocionale, ishin gjithashtu disa nga problemet kryesore të ngritura nga punonjësit e vijës së parë. Disa prej tyre thanë se

“pesha e gjykitimit publik për çka u ka ndodhur i çon në vetëizolim”

dhe se fëmijët

“kanë vështirësi që të integrohen sërish në shoqëri”.

Ata përmendën gjithashtu edhe se izolimi mund të shkaktojë

“probleme emocionale, izolim social, paragjykime”.

Duhet që të ndryshohen urgjentisht qëndrimet dhe reagimet problematike të komunitetit ndaj të mbijetuarve që po përballen me problemet dhe pasojat e shkaktuara nga keqbërës të rritur – pa patur absolutisht asnjë farë faji.